



Republika e Kosovës Republika Kosova • Republic of Kosovo	Institucion i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No.	200412021
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.	23112121
Data/ Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**RAPORT
I
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS
I
AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE PËR FEMRA
DHE NË¹
QENDRËN KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN**

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petitione

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Znj. Fatlinda Mustafa Vuniqi, ushtruese detyre e drejtorit
Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan

Z. Dashnim Osmani, zëvendës drejtor
Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Prishtinë, 23 dhjetor 2021

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (tani e tutje: MKPT) i Avokatit të Popullit, më 26 dhe më 27 tetor 2021 vizitoi Qendrën Korrektuese për Femra (më tej: QKF) dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur (në vijim: QKM) në Lipjan.

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standardet ndërkombe të drejtat e të burgosurve. Gjatë vizitës, në QKF ishin të akomoduara 36 të burgosura, nga to 23 të dënuara, 13 të paraburgosura, ndërsa 2 ishin të vendosura në Institutin e Psikiatrisë Forenzyke (tani e tutje: IPFK) për trajtim të mëtejmë. Ndërsa në QKM, në total ishin të akomoduar 40 të mitur, nga ta 10 të paraburgosur, 19 me masë edukuese dhe 11 të mitur madhorë.

Bashkëpunimi i autoriteteve me MKPT-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës nga MKPT-ja, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovë (ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekspert monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara dhe iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën, si dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

Informimi për të drejtat e të burgosurve

- Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese (Rendi Shtëpiak) përcakton obligimet e institucioneve korrektuese që menjëherë pas pranimit, të sigurojnë kushte që i burgosuri të njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet e tij. Më tej Rendi Shtëpiak përcakton se Rendi Shtëpiak dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) janë në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës. I burgosuri, i cili nuk di shkrim dhë lexim, njoftohet gojarisht për të drejtat dhe për obligimet.¹
- MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se në dispozicion të të burgosurve janë Rendi Shtëpiak dhe dokumenti me “*Të drejtat dhe obligimet e patientëve të burgosur*”, e përgatitur nga DShB-ja, përmes së cilave të burgosurit njoftohen për të drejtat dhe për obligimet e tyre. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur në pavijone dokumente dhe broshura, përmes së cilave të burgosurit marrin informata për pandeminë COVID-19, si dhe informata për ndihmën juridike falas.

¹ Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 20.

Trajtimi

- MKPT-ja gjatë vizitës në QKF dhe në QKM intervistoi një numër të burgosurish dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrekta apo për sjellje të autoriteteve të burgut, të cilat do të përbën shkelje të dinjitetit të të burgosurve. Përveç kësaj, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të burgosurve të të dy qendrave korrekta të Lipjan dhe zyrtarëve korrekta.

Kushtet e akomodimit

- LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe rrethanave vendore klimatike.² Më tej ky ligj përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.*”³
- MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se qelitë ku akomodohen të burgosurat në QKF dhe të miturit të burgosur në QKM kanë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKPT-ja vërejti se hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standartet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).⁴ Po ashtu MKPT-ja gjatë vizitës nuk vërejti mbipopullim në asnjëren qendër korrekta.
- Megjithatë MKPT-ja gjatë vizitës, bazuar në vrojtimet e saj dhe në ankesat e të burgosurave, vërejti se në QKF për të bërrë dush janë 6 kabina dushi në dispozicion të të burgosurave, por vetëm 2 janë funksionale. Po ashtu, si pasojë e gjendjes teknike, nga dushi del uji shumë i nxehëtë dhe të burgosurat detyrohen të gjejnë forma alternative të pastrimit, duke ngrohur ujin në qelitë e tyre.

Ushqimi

- LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurve për ushqim të përshtatshëm, për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tyre, me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të janë të llojlojshme. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.⁵
- Më tej LESP-ja përcakton se personi i dënuar, i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku edhe për ushqim dietal.⁶ Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim, e kontrollon

² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 1.

³ Ligji nr. 05/L0-129, nen 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449/>

⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, par. 1.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, par. 2.

ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij i shënohen në librin përkatës.⁷

9. Në kuzhinën e QKF-së përgatitet ushqimi për tri objektet në Lipjan (QKF, QKM dhe Qendra Edukuese Korrektuese për të Mitur - QEKL). Në kuzhinë janë të angazhuar pesë kuzhinierë, një bukëpjekës dhe rrëth tri të burgosura. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se vetëm kuzhinierët kishin uniformë adekuate, ndërsa të burgosurat e angazhuara në kuzhinë nuk kishin uniforma.
10. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet higjienike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur dhe kuzhina ishte e pajisur me pajisje të reja të nevojshme për ta kryer punën përgatitjen e ushqimit. Stafi i kuzhinës dhe të burgosurat e angazhuara në punë në kuzhinë ishin të pajisur me libreza sanitare.
11. Po ashtu, QKF-ja ofron për të burgosurit ushqim dietal, sipas rekomandimit të mjekut. MKPT gjatë vizitës vërejti se ushqimi është i njëjtë, si për të rriturit ashtu edhe për të miturit. MKPT-ja konsideron se në rastin e të miturve duhet të pasurohet menyja ushqyese, e cila duhet të jetë adekuate me moshën e tyre.

Regjimi

12. Sa i përket regjimit për femra në QKF, MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se shumica e të dënuarave angazhohen në punë në furrë, në kuzhinë, në pastrim, ndërsa gjatë stinës së verës angazhohen në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe në aktivitete të tjera, pasi angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.
13. MKPT-ja vëren se sa i përket angazhimit të të paraburgosurit në punë, nen 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: "*I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme përmes mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos përmes këtë në marrëveshje me drejtorin e institucionit.*"
14. Ndërsa nen 200, paragrafi 1, i LEPS-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: "*I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrëthin e institucionit korrektues përkatës pas marrjes së pëlgimit të gjykatës kompetente.*"
15. MKPT-ja mori ankesa nga të dënuarat, sidomos nga ato me burgim afatgjatë, të cilat pohuan se numri i aktiviteteve dhe i angazhimeve të tjera në dispozicion është dukshëm më i vogël se në periudhën kur ato ishin të akomoduara në pjesën tjetër të qendrës korrektuese.
16. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se KPT-ja, në raportin përmes vizitës në Republikën e Kosovës në vitin 2015, në paragrafin 45 të raportit, ndër të tjera u rekomandon autoritetëve kompetente të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime me prioritet përmes ofruar dhe zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë përmes

⁷ Ligji nr. 04/L-149 përmes Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, par. 3.

gjithë të dënuarit (punë, edukim, sport, rekreacion etj.). Më tej në këtë raport theksohet se vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve me dënimë afatgjata.⁸

17. MKPT-ja vëren se këto ankesa të dënuarat i pohuan edhe para ministres së Drejtësisë gjatë vizitës së saj në QKF-në në Lipjan.⁹ MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të veprojnë në pajtim me rekomandimin e KPT-së lidhur me ofrimin e një regjimi adekuat për këtë kategori.
18. Sa i përket regjimit për të miturit në QKM, MKPT-ja ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditor, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës, përfshirë shkollimin, trajnime për fusha të ndryshme, punë, si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. MKPT-ja u njoftua se në QKM, nga marsi 2021, ka filluar Programi Holandez psikosocial TOPs (i bazuar në programin EQUIP). TOPs u ofron të miturve 4 module: Menaxhimi i zemërimit, shkathësitë sociale, aspekte të vendimmarjes, ndihma e ndërsjellë, që gjithsej zgjat 12 javë.
19. MKPT-ja u njoftua se aktualisht është grupi i dytë i të miturve që vijon programin TOPs, janë trajnuar 10 trajnerë, si: zyrtarët socialë, zyrtarët korrektues, koordinatori për arsim. Sipas drejtorit, në këtë program parashihet që edhe psikologu të jetë pjesë e ekipit, mirëpo psikologu i DShB-së është i kontraktuar vetëm për trajtim të rasteve klinike, e jo për angazhime të tjera psiko-sociale.
20. MKPT-ja vlerëson lart angazhimin e QKM-së në ofrimin e programeve të tilla psiko-sociale dhe gjithashtu inkurajon autoritetet, si MD-në, që të ndërmarrin hapa konkretë për fuqizimin e ekipit multidisiplinor psiko-social, duke angazhuar psikolog shtesë.
21. MKPT-ja u informua se aktualisht 34 të mitur janë të angazhuar në punë, 23 prej tyre të mitur, 11 madhorë). Të miturit e dënuar dhe ata me masë edukative, rutinën ditore e kanë të veçantë, një orë në ditë kanë aktivitete sportive, ndërsa të paraburgosurit tri herë në javë. Zakonisht aktivitetet sportive që zhvillohen janë: basketball, futboll, volejboll, fitnes.
22. Gjithashtu ofrohet edhe Aftësimi Profesional për të miturit në QKM dhe në QEKL në katër lëmi: 3 të mitur në programin për hidroinstalues, 2 në ndërtimtari, 4 në TIK dhe 2 në elektroinstalues.
23. Në shkollën e QKM-së në Lipjan zhvillohet mësimi vetëm për nivelin e shkollimit të mesëm të ulët dhe për atë të lartë. MKPT-ja gjatë vizitës u informua se në QKM aktualisht janë 20 të mitur që vijojnë mësimin, 7 prej tyre janë në nivelin e shkollimit të mesëm të ulët, 13 në shkollimin e mesëm të lartë.
24. Po ashtu janë 4 të mitur të cilët do të duhej t'i ndiqnin mësimet në nivelin fillor, ndërsa 2 nga ta nuk e kanë mbaruar as klasën e parë fillore dhe nuk dinë shkrim-lexim. Raste të tilla ka pasur edhe në vitet e kaluara. Arsyjeja e mosndjekjes së mësimit fillor është se në QKM mungon programi fillor i arsimimit.
25. Meqenëse shkolla në QKM funksionon si paralele e ndarë e ShFMU “Ismail Luma” në Lipjan, koordinatori për Arsim dhe Programe në QKM, më 6 tetor 2021 i është drejtuar me shkrim drejtoreshës së Drejtorisë Komunale për Arsim (DKA) në Lipjan dhe e ka

⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, publikuar në vitin 2016.

⁹ Lidhur me vizitën e ministres së Drejtësisë në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, shih komunikatën për media, në: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2597>

njoftuar për situatën aktuale dhe ka kërkuar që DKA-ja të ndërmarrë hapat e nevojshëm për tejkalimin e këtij problemi në mënyrë që të miturve t'u mundësohet qasja e barabartë në arsim, ashtu siç është garantuar edhe me legjislacionin në fuqi.

26. Lidhur me këtë, neni 83, paragrafi 1, i LESP-së, përcakton “*Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesém në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesém.*” Gjithashtu në ligj theksohet se përgjegjës për arsimimin fillor dhe të mesém në institucionin korrektues është ministria kompetente për arsim. Neni 83, paragrafi 4 përcakton: “*Për personat e dënuar që nuk din shkrim lexim organizohen kurse të posaçme.*”
27. MKPT-ja vlerëson lart faktin që dy të mitur në QKM dhe një e mitur madhore në QKF vijojnë studimet universitare *online* dhe përmes pranisë fizike në provime. Gjatë vizitës në QKM, MKPT-ja vizitoi edhe bibliotekën, e cila sipas koordinatorit për arsim dhe programe, posedon rreth 4000 ekzemplarë.

Kujdesi shëndetësor

28. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilat nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjeter për përkujdesje shëndetësore.¹⁰
29. Personeli mjekësor i QKF-së përbëhet nga një mjek i rregullt me orar të plotë (08:00-16:00), i cili punon me orar të koordinuar, pasi i njëjtë është në specializim. Po ashtu në dispozicion të njësisë shëndetësore janë 5 infermierë (4 + kryeinfermierja) të rregullt, ku 4 infermierë punojnë me ndërrime nga 24 orë (momentalisht sipas orarit të përshtatur me masat kundër pandemisë COVID-19), kurse kryeinfermierja punon me orar 8-16. Psikologia është në dispozicion me orar të plotë 8:00-16:00. Stomatologu është i rregullt në të dy qendrat korrektuese.
30. Konsultimet ofrohen edhe nga psikiatri i cili është në dispozicion një herë në javë, ndërsa radiologu një herë në javë dhe sipas nevojës. Gjinekologia ofron shërbime sipas nevojës pa orar të caktuar. Gjate vitit është bërë mamografia dhe paptesti për rastet me indikacione. Analizat laboratorike janë bërë një herë në vit. Sa u përket shërbimeve të tjera specialistike, ato kryhen në koordinim me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Lipjan dhe me klinikat përkatëse të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).
31. Njësia shëndetësore në QKM përbëhet nga një mjek i rregullt me orar të rregullt 8:00-16:00 dhe në thirrje (me orar të koordinuar pasi vijon specializimin në pediatri), 5 infermierë (4 + kryeinfermierja) të rregullt, ku 4 infermierë punojnë me ndërrime nga 24 orë, kurse kryeinfermierja me orar 8:00-16:00. Po ashtu ofrohen shërbime nga psikologia e cila punon me orar të rregullt. Sa i përket infrastrukturës ku ofrohen shërbimet mjekësore dhe pajisjeve mjekësore në dispozicion, gjendja është në nivel të kënaqshëm në të dy qendrat korrektuese.
32. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se në QKF vazhdon të jetë sfidë prania e kohëpaskohshme e të burgosurave me sëmundje mendore. MKPT-ja gjatë vizitës intervistoi 6 të burgosura me çrregullime mendore, ku 4 nga to janë vështirë të

¹⁰ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, par. 2.

menaxhueshme. E burgosura M. K. i ka sulmuar fizikisht edhe të burgosurat e tjera. E mitura e burgosur B. S. është pranuar në QKF në Lipjan më 9 shtator 2021 dhe gjatë qëndrimit në burg dy herë ka tentuar të vetëvritej dhe disa herë është vendosur nën vëzhgim permanent.

33. Sipas stafit shëndetësor dhe korrektues, është rast vështirë i menaxhueshëm dhe nuk duhet të trajtohet në burg. Bazuar në raportin shëndetësor, e mitura ishte dërguar më 17 shtator 2021 për trajtim ambulator në Institutin e Psikiatrisë Forenziqe (IPFK) dhe prapë është kthyer në QKF, për shkak se IPFK-ja nuk ka hapësirë për ta akomoduar për trajtim të mëtejmë. Sipas raportit, e mitura është në proces të ekzaminimit nga Klinika Psikiatrike e Fëmijëve në QKUK. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se neni 50 i LESP-së shprehimisht përcakton: “*Nëse personi i dënuar vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë shëndetësore merren masa që atij t'i ofrohet trajtimi më i mirë i mundshëm.*”
34. Po ashtu standardet e KPT-së përcaktojnë si në vijim: “*Një i burgosur i sëmurë mendor duhet të mbahet dhe përkujdeset në një mjedis spitalor që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik i pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut.*”¹¹
35. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 12.1, përcaktojnë si në vijim: “*Personat të cilët vuajnë nga sëmundjet mendore të cilat nuk janë kompatibile me akomodimin në burg duhet të akomodohen në institucionin e paraparë veçanërisht për këtë qëllim.*”¹²
36. Rregullat e Mandelës, Rregulli 109, përcaktojnë se të burgosurit me probleme mendore nuk duhet të mbahen në burgje, por duhet të bëhen përpjekje që ata të transferohen në institucione përkatëse sa më shpjet që të jetë e mundur.
37. Lidhur me këtë problematikë, MKPT-ja, e përkrahur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, ka organizuar disa tryesa diskutimi me institucionet kompetente shëndetësore, me ç'rast u diskutuan modalitetet për zgjidhjen e kësaj problematike, në mënyrë që trajtimi i personave të privuar nga liria e tyre të jetë në pajtim me legjislacionin vendor dhe me standardet ndërkontaktare përfshirë drejtat themelore të njeriut.
38. Me rastin e shënimit të 10 tetorit - Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, më 11 tetor 2021 Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim më Këshillin e Evropës, organizuan një konferencë përfshirë shënimin e kësaj dite të rëndësishme. Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut përfshirë standardet ndërkontaktare në fushën e vendosjes së pavullnetshme në institucione të mbyllura psikiatrike të personave me çrrëgullime mendore të privuar nga liria.
39. Konferenca u organizua në vazhdën e gjetjeve dhe rekomandimeve të KPT-së dhe të MKPT-së së Avokatit të Popullit, pas vizitave të tyre në institucionet e mbyllura psikiatrike në Republikën e Kosovës, në tetor 2020. Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të institucioneve kompetente, ku prezantuan planet e tyre përfshirë zgjidhur këtë problematikë.¹³

¹¹ Standardet e KPT-së, pjesë nga Raporti i Tretë i Përgjithshëm, paragrafi 43, publikuar në vitin 1993. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

¹² Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 47.1. Shih në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ac>.

¹³ Për më shumë, shih në: <https://oik-rks.org/2021/10/11/iap-shenoi-diten-boterore-te-shendetit-mendor/>.

40. MKPT-ja sërisht inkurajon autoritetet kompetente që të bëjnë përpjekje të vazhdueshme që këta persona të trajtohen në institacione përkatëse, qoftë në ndonjë njësi të veçantë psikiatrike brenda burgut, në ndonjë spital, apo në institucion psikiatrik civil. MKPT-ja do të vazhdojë t'i ndjekë veprimet që do t'i ndërmarrin autoritetet lidhur me trajtimin e kësaj kategorie.

Rëndësia e kontrolleve mjekësore për të burgosurit e sapopranuar

41. LESP-ja¹⁴ dhe Praktika Standarde e Veprimit¹⁵ e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteteve kompetente që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
42. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant, të sapopranuarit brenda 24 orëve u nënshtrohen kontrolleve mjekësore në pajtim me LESP-në dhe me Praktikën Standarde të Veprimit të DShB-së.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

43. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me LESP-në, me Praktikën Standarde të Veprimit, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me standartet e KPT-së, si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria
44. Sa i përket konfencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurat, me të miturit e burgosur dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrekta, përvèç në rastet kur prania e tyre kërkonit nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

Kontakti me botën e jashtme

45. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit e tjerë, janë të rëndësishëm thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
46. Legjislacioni në fuqi,¹⁶ për rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korresponcencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe kanë të drejtë për një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh.
47. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i LESP-së përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. Në rastin e të paraburgosurve, këto telefonata autorizohen nga gjykata kompetente.
48. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në QKF të dënuarave u mundësohen 4 vizita në muaj, atyre në regjim standard u mundësohen dy telefonata në javë, kurse të dënuarave në regjim standard u mundësohen telefonata pa kufizime, si dhe e drejta për vikende në

¹⁴ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

¹⁵ Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf/>

¹⁶ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

rastet kur plotësohen kriteret ligjore. Kurse të paraburgosurave në QKF, me leje të gjykatës kompetente, u mundësohet nga një telefonatë në javë.

49. Në QKM, të miturve të dënuar u lejohet një vizitë në dy javë dhe telefonata, ndërsa në rastin e të miturve të paraburgosur, telefonatat dhe vizitat lejohen me leje të gjykatës kompetente.
50. Të gjitha këto të drejta mund të jenë subjekt i kufizimeve për shkak të pranisë së pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës. MKPT-ja ka vërejtur se kufizimet e së drejtës për kontakte me botën e jashtme janë kompensuar duke u ofruar të burgosurve më shumë telefonata dhe komunikim përmes sistemit SKYPE.
51. MKPT-ja vizitoi edhe sallën e vizitave familjare, e cila ofron kushte të kënaqshme për të pranuar vizita familjare, si dhe ofron mundësinë që i burgosuri të ketë kontakt të drejtpërdrejtë (nuk ka bariera ndërmjet tyre) me familjarin apo me personin nga i cili vizitohet.

Procedura e parashtrimit të ankesave

52. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.¹⁷
53. Neni 91.i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK-së. Procedura përfshin edhe afatet përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.¹⁸
54. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve janë kutitë e ankesave, të vendosura nga ShKK-ja, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
55. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
56. MKPT-ja vërejti se të burgosurve u ofrohet mundësia adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër, në pajtim me LESP-në. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë apo kërkesë.

¹⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 27-të i Përgjithshëm, paragrafi 68. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16807bc668>.

¹⁸ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.”


Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit u

REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- Të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat (përshirë të paraburgosurat), kur një gjë e tillë është e mundur. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve të dënuar me dënimë afatgjata.
- Të burgosurat e angazhuara në punë në kuzhinë të pajisen me uniforma adekuate.
- Të bëhen rregullimet teknike të dusheve në QKF, në mënyrë që të mundë të përdoren në mënyrë adekuate nga të burgosurat.
- Të organizohen kurse të veçanta për të burgosurit të cilët nuk din shkrim dhe lexim.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me ndërime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit